

Nr. 1395  
04.11.2017



M. Shala

UNIVERSITETI I TIRANËS  
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT

Nr. 5753 Prot

Tiranë më 13.11.2017

**LËNDA:** Përcjellje informacioni mbi mundësi aplikimi për bursa mobiliteti Erasmus + në South-West University "Neofit Rilski" në Bullgari.

**DREJTUAR:** Prof. Dr. Artur Sula,  
Dekan i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja

Inderuar z. Dekan,

Në kuadër të programit Erasmus + KA107, është hapur thirrja për aplikime për bursa shkëmbimi për studime dhe bursa mobiliteti për mësimdhënie në South-West University "Neofit Rilski" në Bullgari, për studentët dhe stafin akademik të Universitetit të Tiranës.

Dokumentacioni duhet të dorëzohet dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit, Sektori për Marrëdhëniet me Jashtë si edhe të dërgohet i skanuar përmes postës elektronike në adresën [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al). Bashkëngjitur gjeni informacione të mëtejshme në lidhje me procedurën e aplikimit dhe dokumentacionin e nevojshëm.

Të përcillet informacioni në strukturat e fakultetit tuaj si edhe të publikohet informacioni bashkëngjitur në website-in e fakultetit tuaj.

Duke ju falenderuar për mirekuptimin,



## **Hapet Thirrja për Bursa në Kuader të Programin Erasmus + në South-West University “Neofit Rilski”, në Bullgari, për semestrin e dytë të vitit akademik 2017-2018**

Universiteti i Tiranës hap thirrjen për aplikime për bursa për mobilitete në South-West University “Neofit Rilski”, në Bullgari në kuadër të programit Erasmus +, për studentët dhe stafin akademik të UT-së, për semestrin e dytë të vitit akademik 2017-2018.

### **Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbimin e studentëve për studime;
- Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie;

### **Nivelet e mobilitetit për studentët:**

- Bachelor
- Master
- PhD

### **Kohëzagjatja e bursave:**

- Bachelor (5 muaj);
- Master (5muaj);
- PhD (5 muaj);
- Stafi akademik për mësimdhënie 5 ditë + 2 ditët ë udhëtimit;

### **Fushat e studimit:**

- Gjuhë Bullgare;
- Gjuhë Angleze;
- Gjuhë Ruse;
- Gjuhë Gjermane;

Për t'u njojur me katalogun e programeve të studimit të ofruara nga South-West University “Neofit Rilski” klikoni në:

**<http://en.swu.bg/>**

## **Bursat përfshijnë:**

- Kompensimin mujor (750 EUR në muaj për studentët);
- Kompensim ditor (140 EUR për stafin akademik);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës);

DISTANCA E UDHËTIMIT ( <a href="http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm">http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm</a> )	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnje tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifat e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

## **Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët Bachelor:**

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti i nivelit Bachelor;
- Listë notash (të përkthyera zyrtarisht në gjuhën angleze);
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Certifikatë e gjuhës së huaj B2 (Bullgarisht/Anglisht/Rusisht/Gjermanisht/ në vartësi të programit të studimit) ;

-\*Learning Agreement;

\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvilloni në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Before the Mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në universitetin pritës lëndë të njëjtë me ato që do të kryenit në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni/frekuentoni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti "Learning Agreement" tek seksioni "Commitment" firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën: <http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning%20Agreement.pdf>

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit **Master**:

- CV (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti të nivelit **Master**;
- Listë notash e nivelit Bachelor (të përkthyera në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);
- Listë notash e nivelit Master (të përkthyera në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);

- Certifikatë e gjuhës së huaj B2(Bullgarisht/Anglisht/Rusisht/Gjermanisht/në vartësi të programit të studimit);

-\*Learning Agreement;

\**Learning Agreement* është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvilloni në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Before the Mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.

**KUJDES:** Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në universitetin pritës lëndë të njëjtë me ato që do të kryenit në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni/frekuontoni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti "Learning Agreement" tek seksioni "Commitment" firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën: [http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning\\_Agreement.pdf](http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf)

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit **PhD**,

-CV (në gjuhën angleze);

- Kopje e Pasaportës;

- Vërtetim studenti të nivelit PhD;

- Listë notash e nivelit Master (të përkthyera në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);

- Listë notash e nivelit PhD (të përkthyera në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);

- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);

- Certifikatë e gjuhës së huaj B2 (Bullgarisht/Anglisht/Rusisht/Gjermanisht/në vartësi të programit të studimit) ;

- \*Learning Agreement;

\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvilloni në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Before the Mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të nijhet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në universitetin pritës lëndë të njëjtë me ato që do të kryenit në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t'ju nijhen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni/frekuentoni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti "Learning Agreement" tek seksioni "Commitment" firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën: [http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning\\_Agreement.pdf](http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf)

**Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik për mësimdhënie:**

- CV+ Lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);
- Certifikata e gjuhës së huaj B2 (Bullgarisht/Anglisht/Rusisht/Gjermanisht/në vartësi të programit të mësimdhënieς);
- Plani i mobilitetit për mësimdhënie\*;

Për të shkarkuar formatin e Planit te Mobilitetit për Mësimdhënie klikoni në adresën:

<http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Teaching Mobility Plan.pdf>

\*Plani i Mobilitetit për stafin akademik është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

**Afati për aplikim: 24 Nëntor 2017**

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al me subjekt, emrin dhe mbiemrin tuaj si dhe universitetin në të cilin po aplikoni.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!